



Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh dhe stafi akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në Universitetin e Poitiers, në Ecole Nationale Supérieure D'ingénieurs De Poitiers (ENSIP), Francë.

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete, për studentë dhe staf akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Universitetin e Poitiers, në Ecole Nationale Supérieure D'ingénieurs De Poitiers (ENSIP), Francë.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor dhe Master për studime;
- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

Studentët Bachelor duhet të kenë përfunduar një vit studimi dhe studentët Master duhet të jenë të regjistruar në programin e studimit Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.**

Kohëzgjatja e bursave për studentët:

Një semestër, pranverë 2022.

Numri total i studentëve (Bachelor ose Master):

- 2 studentë - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;
- 2 studentë - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- 2 studentë - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor për studentët Master;
- Listë notash të studimeve deri në momentin e aplikimit, (Aplikuesit duhet të kenë notë mesatare të studimeve mbi 7.0.);
- Letër Motivimi, në gjuhën franceze ose angleze;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*.



**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën franceze ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. Kurset e studimit në ENSIP zhvillohen kryesisht në gjuhën franceze. Gjithashtu, mund të ofrohen kurse edhe në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

Numri total i stafit: 6 staf akademik

- 2 pedagogë - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;
- 2 pedagogë - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
- 2 pedagogë - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Kohëzgjatja e bursave për stafin: deri 11 ditë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Certifikatë e gjuhës së huaj*;
- Vërtetim pune;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching Mobility Agreement.

*Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2 për kurset në gjuhën franceze dhe B2 për kurset në gjuhën angleze. Stafi duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me certifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

Afati për aplikim për studentët dhe stafin, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:
Deri më 30 shtator 2021

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në email:
rkodra@upt.al ose abeqo@upt.al